MAL BERISHA

MIRUSH KABASHI SHFAQ "APOLOGJINË E VËRTETË TË SOKRATIT" NË TEATRIN LONDINEZ "KINGS PLACE"

1

MAL BERISHA

MIRUSH KABASHI SHFAQ “APOLOGJINË E VËRTETË TË SOKRATIT” NË TEATRIN LONDINEZ “KINGS PLACE”

TEATRI “KINGS PLACE” NË LONDËR ËSHTË NJË NDËR HAPËSIRAT SKENIKE MË TË NJOHURA DHE TË VLERËSUARA NË BOTË.

Kings Place është një qendër kulturore moderne në zemër të Londrës, e njohur për akustikën e shkëlqyer dhe programin e pasur artistik. E hapur në vitin 2008, ajo përfshin dy salla koncertesh, galeri arti, hapësira konferencash dhe është shtëpia e disa prej institucioneve më të rëndësishme muzikore dhe kulturore në Mbretërinë e Bashkuar.

Më 23 tetor 2014, në sallën e teatrit londinez “Kings Place”, nën kujdesin e Ambasadës së Shqipërisë në Londër, u organizua shfaqja e monodramës **“Apologjia e Vërtetë e Sokratit”**, interpretuar nga aktori ynë i mirënjohur, **Artist i Merituar** dhe **Mjeshtër i Madh i Skenës**, **Mirush Kabashi**.

Në një sallë të tejmbushur me diplomatë, me stafin e dy ambasadave – asaj të Shqipërisë dhe të Kosovës – si dhe me pjesëmarrës shqiptaro-britanikë, anglezë dhe të huaj të tjerë, artisti ynë arriti të përcillte te publiku vlerat e një interpretimi autentik artistik të një niveli shumë të lartë, duke dëshmuar forcën e jashtëzakonshme të fjalës shqipe në skenën ndërkombëtare.

Shfaqja u njoftua përmes kanaleve zyrtare për mbi **53,000 anëtarë** të klubit të teatrit **Kings Place** në mbarë botën.

Shfaqja ishte një sukses i plotë dhe i merituar.

TIRANË, 25 Tetor / ATSH – Almarina Gegvataj / – Artisti i Merituar dhe Mjeshtër i Madh i Skenës Shqiptare, Mirush Kabashi, vijon të përcjellë me shumë emocion forcën e fjalës shqipe në skenat më prestigjioze të botës.

“Apologjia e Vërtetë e Sokratit”, e interpretuar nga aktori ynë i mirënjohur, është shfaqur në sallën e teatrit londinez “Kings Place”, nën kujdesin e Ambasadës Shqiptare në Londër.

Në një sallë të tejmbushur me diplomatë, me stafin e dy ambasadave – të Shqipërisë dhe Kosovës – si dhe me pjesëmarrës shqiptarë të Britanisë, qytetarë anglezë dhe të huaj nga vende të tjera, artisti ynë arriti të përçonte te publiku vlerat e një interpretimi të lartë artistik dhe fuqinë shprehëse të gjuhës shqipe në skenë.

Dhënia e kësaj shfaqjeje, e cila ishte një sukses i plotë dhe i merituar, – thotë Ambasadori Mal Berisha – u njoftua paraprakisht përmes kanaleve zyrtare të teatrit "Kings Place" për mbi 53.000 anëtarë të këtij klubi në mbarë botën.

Me këtë monodramë, Mirush Kabashi ka lartësuar gjuhën dhe teatrin shqiptar në disa nga skenat më prestigjioze ndërkombëtare: në Paris, Vjenë, Kajro, Kiev, Toronto, Athinë, Beograd, Prishtinë, Lion, Plovdiv, Gjenevë etj., duke marrë duartrokitje dhe vlerësime të veçanta kudo ku ka interpretuar.

Monodrama “Apologjia e Vërtetë e Sokratit”, e bazuar në pamfletin e shkrimtarit grek Kostas Varnalis, u vu për herë të parë në skenën e Teatrit Kombëtar të Tiranës në vitin 1997. Po atë vit, pas interpretimit të saj në edicionin e nëntë të Festivalit Ndërkombëtar Eksperimental të Teatrit në Kajro (Egjipt), Mirush Kabashi u nderua me çmimin “Sfinksi i Artë” si interpreti më i mirë mes 1000 aktorëve nga 46 vende të botës.

Artisti i madh Mirush Kabashi zhvillon një bisedë rreth teatrit me shqiptarët britanikë në sallën “Aubrey Herbert & Edith Durham” të Ambasadës së Shqipërisë në Londër.

Në foto: Artisti së bashku me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, Sh.T. z. Mal Berisha.

Gjatë këtyre viteve, “Apologjia e Vërtetë e Sokratit” është shfaqur mbi 100 herë, thuajse në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Në vitin 1998, aktori Mirush Kabashi u nderua nga Presidenti i Republikës me titullin “Mjeshtër i Madh i Punës”.

Kjo monodramë, e para në historinë e teatrit shqiptar, ka marrë vlerësime të shumta edhe në skenat ndërkombëtare. Në Festivalin Mesdhetar “Butrinti 2002”, Kabashi u shpall aktori më i mirë, ndërsa të njëjtin vlerësim e mori edhe në Festivalin Ndërkombëtar “Kiev-Traverny” në Ukrainë.

Në Festivalin Ndërkombëtar të Plovdivit në Bullgari, ai u nderua me Kupën e Ministrit të Kulturës, ndërsa në Kajro, në vitin 1999, mori Medaljen e Karrierës, një tjetër dëshmi e nivelit të lartë artistik dhe e vlerësimit ndërkombëtar që ka gëzuar ky interpretim i jashtëzakonshëm.

“Apologjia e Vërtetë e Sokratit” ka marrë pjesë në disa festivale ndërkombëtare, përfshirë Festivalin e Manastirit në Maqedoni, “Sllavia 2004” në Beograd, si dhe Festivalin “Teuta 2007” në Kotorr, Mali i Zi.

Aktori Mirush Kabashi, një nga figurat më të spikatura të skenës shqiptare, numëron në karrierën e tij mbi 100 role teatrale dhe mbi 20 role të tjera në kinematografi, duke

dëshmuar një krijimtari të pasur dhe të qëndrueshme në dekada.